

LIGJ
Nr.7377, datë 8.5.1990

PËR BANKËN E SHTETIT SHQIPTAR

Me qëllim që Banka e Shtetit Shqiptar të luajë rol aktiv për zhvillimin e ekonomisë dhe rritjen e efektivitetit të saj nëpërmjet monedhës, kreditit dhe forcimit të disiplinës financiare e të kontrollit dinamik me anë të lekut.

Në mbështetje të nenit 67 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Banka e Shtetit Shqiptar si institucion qendror shtetëror, zbaton politikën ekonomike për zhvillimin dhe forcimin ekonomiko-financiar të ndërmarrjeve, të institucioneve e të kooperativave bujqëore dhe ushtron kontroll me anë të lekut, për të parandaluar çdo veprim që vjen në kundërshtim me disiplinën e planit e të financës.

Neni 2

Banka e Shtetit Shqiptar ka këto të drejta e detyra:

- a) nxjerr (emeton) monedhën;
- b) jep kredi në lekë e në valutë;
- c) kryen financimin e investimeve dhe të ndërtimeve themelore dhe ushtron kontroll për studimin e leverdisshmërisë së tyre në bazë të dokumentacionit të depozituar në bankë;
- ç) kryen veprimet e thesarit dhe të arkës për buxhetin e shtetit;
- d) kryen veprimet juridike në lidhje me metalet e gurët e çmuar dhe valutat e huaja;
- dh) përqendron llogaritë e pagesave e të arkëtimeve të ndërmarrjeve, institucioneve e organizatave shoqëore, kryen arkëtimet e pagesat dhe bën grumbullimin e mjeteve monetare;
- e) ushtron kontroll për qarkullimin e monedhës dhe përdorimin e fondit të pagave, për përdorimin e kredive, të fondeve të investimeve, për valutën dhe metalet e çmuara, për veprimet e arkës së buxhetit të shtetit dhe për arkëtimet e pagesat ndërmjet ndërmarrjeve e institucioneve dhe në marrëdhëniet me jashtë shtetit;
- ë) mban përgjegjësi për qëndrueshmërinë dhe rritjen e fuqisë blerëse të monedhës, për përdorimin e drejtë dhe rritjen e efektivitetit të kreditit në lekë e në valutë, si dhe për forcimin e disiplinës në financimin e investimeve, të arkëtimeve e të pagesave.

Neni 3

Banka e Shtetit Shqiptar nxjerr dhe vë në qarkullim bileta banke dhe monedha metalike, të cilat garantojnë nga shteti me mallra, ar, metale të tejra të çmueshme, valutë të huaj e me veprimtari të Bankës.

Njësia monetare në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë është leku.

Lloji, sasia dhe premjet e biletave të bankës e të monedhave metalike, si dhe rregullat për nxjerrjen e sjelljen nga jashtë shtetit të tyre, caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 4

Banka e Shtetit Shqiptar merr pjesë në të gjitha veprimtaritë dhe marrëveshjet shtetërore me karakter ekonomik e financiar që vendi ynë zhvillon me jashtë. Vendosi marrëdhënie dhe lidh

marëveshje bankara me bankat e huaja, si dhe mban depozita e llogari të bankave të huaja dhe depozita e llogari të saj pranë tyre;

Banka e Shtetit Shqiptar mban llogari në valutë të huaj të personave të tjerë juridikë e fizikë të huaj dhe shqiptarë, si dhe kryen këmbime valutore për nevojat e saj e të klientëve të saj, brenda dhe jashtë shtetit.

Neni 5

Banka e Shtetit Shqiptar tregon tituj me vlerë në valutë të huaj dhe dokumente financiare e tregtare, si dhe lëshon e pranon garanci bankare, në bazë të kritereve të caktuara prej saj.

Neni 6

Banka e Shtetit Shqiptar mban sekret të gjitha marrëdhëniet me klientët e saj, në lidhje me depozitat e llogaritë e tyre dhe me veprimet që bëhen për to.

Neni 7

Banka e Shtetit Shqiptar jep kredi afatshkurtër e afatgjatë, në kusht që të përdoret për qëllimin e caktuar, të garantohet me vlera materiale dhe të kthehet në afat.

Për kreditë e dhëna Banka e Shtetit Shqiptar merr interes.

Burimet për dhënie e kredive formohen nga mjetet e veta të Bankës dhe nga teprica e mjeteve monetare përkohësisht të lira të buxhetit të shtetit, të ndërmarrjeve, të institucioneve, të organizatave shoqërore e të personave të veçantë, të cilat grumbullohen në Bankë.

Banka e Shtetit Shqiptar u jep interes ndërmarrjeve, institucioneve dhe personave të veçantë për mjetet monetare që depozitohen në të.

Neni 8

Kredi afatshkurtër u jep ndërmarrjeve për plotësimin e mjeteve të xhiros për zhvillimin e veprimtarisë pordhuese.

Kredi afatgjatë u jepet ndërmarrjeve për investime të reja me karakter prodhues e rikonstruksione teknike e teknologjike të objekteve ekzistuese prodhuese e të shërbimeve.

Banka u jep kredi me afate të caktuara punonjësve që banojnë në qytet për përmirësimin e kushteve të banimit si dhe kredi të pjesshme për plotësimin e nevojave me banesa të reja.

Neni 9

Banka e Shtetit Shqiptar merr pjesë aktive në procesin e studimit e të planifikimit dhe jep mendime për përfshirjen e investimeve në plan dhe për radhën prioritarë të kryerjes së tyre.

Banka për investimet që krediton, shqyrton e kontrollon studimet, projektet e preventivat dhe miraton dhënie e kredisë, në bazë të treguesve të leverdisshmërisë ekonomiko-shoqërore. Ajo ndjek dhe kontrollon kryerjen e punimeve sipas projekteve e preventivave, vënien në shfrytëzim në afat të tyre, si dhe realizimin e treguesve të efektivitetit, deri në shlyerjen e plotë të kredisë.

Kur vëren shkelje të rregullave dhe mangësi nga qëllimi ose destinacioni i investimit, Banka pezullon financimin dhe urdhëron ndërprerjen e punimeve duke njoftuar organet përkatëse.

Neni 10

Banka e Shtetit Shqiptar kur vëren se kredia nuk është përdorur për qëllimin e dhënë, ndërpret menjëherë kreditimin e mëtejshëm, kërkon kthimin para afatit të kredisë së dhënë dhe për ndërmarrjet njofton ministrinë përkatëse, si dhe komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit.

Kur kredia nuk kthehet në afat ose nuk garantohet me vlera materiale, Banka ndërpret a kufizon dhënie e mëtejshme të kredisë, ose kërkon kthimin e menjëhershëm të saj. Për kreditë e pakthyera në afat zbatohet interes më i lartë se për kreditë e rregullta.

Neni 11

Kriteret për planin e arkës, për përdorimin e fondit të pagave, për kreditin e financimin e investimeve, si dhe për interesin bankar, caktohen me dispozita të veçanta të Këshillit të Ministrave,

Neni 12

Banka e Shtetit Shqiptar ka këto fonde:

- a) fondin e themelimit prej 750 milionë lekësh;
- b) fondin rezervë prej 250 milionë lekësh;
- c) fondin e mjeteve kryesore.

Neni 13

Banka e Shtetit Shqiptar organizohet sipas parimit me llogari më vete. Nëntëdhjetë përqind e së ardhurës neto të planifikuar dhe shtetëdhjetë për qind e asaj mbi plan derdhet në buxhetin e shtetit. Pjesa tjetër përdoret për fuqizimin e fondeve të Bankës për investime etj., sipas kriterëve të caktuara me dispozita të veçanta.

Bilanci vjetor i Bankës së Shtetit Shqiptar miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 14

Shteti garanton të gjitha detyrimet e Bankës së Shtetit Shqiptar që rrjedhin nga veprimet e kryera në bazë të këtij ligji.

Neni 15

Banka e Shtetit Shqiptar është person juridik me qendër në Tiranë, ka rrjetin e saj në rrethe, varet nga Këshilli i Ministrave dhe përgjigjet e jep llogari para tij. Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar, për kryerjen e detyrave, ka aparatin e saj.

Drejtori i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar drejton Bankën dhe përgjigjet për të tërë veprimtarinë e saj, e përfaqëson atë ose autorizon të tjerë që ta përfaqësojnë.

Neni 16

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Bankës krijohet Këshilli i Bankës së Shtetit Shqiptar, si organ konsultativ, që kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar, i cili miraton edhe përbërjen e këtij këshilli.

Neni 17

Degët e bankës së Shtetit Shqiptar të rretheve varen nga Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar dhe, për kryerjen e funksioneve e të detyrave, ato kontrollohen e japin llogari para saj, si dhe para komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit.

Neni 18

Ministritë, institucionet e tjera qendrore dhe ndërmarrjet, sipas kërkësës së Bankës së Shtetit Shqiptar, i paraqesin kësaj planet financiare, bilanci dhe të dhëna të tjera për të bërë studime, analiza e kontrolle me karakter ekonomik e financiar.

Neni 19

Drejtorja e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar, në bazë dhe për zbatim të dispozitave

të këtij ligji e të dispozitave të Këshillit të Ministrave, jep udhëzime që janë të detyrueshme për ministritë, institucionet e tjera qendrore dhe organet e tyre vartëse.

Neni 20

Banka e Shtetit Shqiptar, për shkeljet e dispozitave të këtij ligji, ka të drejtë të ngarkojë me përgjegjësi administrative e materiale shkaktarët, sipas rregullave të përcaktuara me dispozita të veçanta.

Neni 21

Banka e shtetit Shqiptar ka vulën e saj me shenjat e stemës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Neni 22

Dekreti nr.5529, datë 25.2.1977 "Për Bankën e Shtetit Shqiptar", shfuqizohet.

Neni 23

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 1991.

SEKRETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
SIHAT TOZAJ

KRYETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
RAMIZ ALIA